

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit “E. P.” SH.P.K“ me seli në Gj. Komuna e Sh., të cilën e përfaqësoi përfaqësuesi ligjor i paditësit S. K. , kundër të paditurit NTP”P.” me seli në P., për shkak të borxhit, vlera e kontestit 73,728.86 €, në seancën e mbajtur më datë 29.05.2017, në prani të përfaqësuesit së autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të të paditurës,ka marrë këtë;

A K T G J Y K I M

PËR SHKAK TË MOSBINDJES

APROVOHET kërkespadija e paditësit “E. P.” SH.P.K“ me seli në Gj. Komuna e Sh. .

DETYROHET e paditura NTP”P.” me seli në P. që në emër të borxhit t’ia paguaj paditësit “E. P.” SH.P.K“ me seli në Gj. Komuna e Sh., shumën prej 73,728.86euro(shtatë dhjetë e tri mijë e shtatëqind e njëzet e tetë euro e tetëdhjetë e gjashtë cent) me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 19.01.2013 e deri në pagesën definitive,të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së Aktgjykimit,nën kërcnimin e përmbarrimit me detyrim.

DETYROHET e paditura që paditësit të ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 368,64,00 euro.

A r s y e t i m i

Paditësi “E. P.” SH.P.K“ me seli në Gj. Komuna e Sh. ka parashtruar padi me datë 11.03.2016 pranë kësaj gjykate kundër të paditurit NTP”P.” me seli në P. , duke kërkuar që t’ia paguaj në emër të borxhit shumën prej 73,728.86euro ,me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 11.03.2016 e deri në pagesën definitive,njëherit ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga shkresat e lëndës gjykata ka konstatuar se i padituri me datë 29.11.2016 ka pranuar nga gjykata aktvendimin për përgjigje në padi, e që vërtetohet nga fletëkthesa e PTK-së, ndërsa e paditura nuk ka dhënë përgjigje në padi.

Përkundër kësaj, gjykata ka caktuar seancën përgaditore, me datë 29.05.2017 dhe ia ka dërguar të paditurit ftesën, e cila është pranuar nga i padituri me datë 15.04.2017,që vërtetohet nga fletëkthesat te cilat gjinden në shkresat e lëndës,mirpo i padituri edhe pse i ftuar me rregull nuk ka prezentuar në seancën e datës 29.05.2017,ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar.

Meqenëse i padituri nuk ka vepruar sipas aktvendimit të gjykatës III.Ek.168/16 të datës 26.10.2016,duke mos dhënë përgjigje në padi,si dhe nuk prezntoi në seancën përgaditore, përfaqësuesi i paditësit i ka propozuar gjykatës, të merr aktgjykim për shkak të mosbindjes.

Meqenëse bazushmëria e kërkespadiisë rezulton nga faktet e paraqitura në padi,nga fletëdërgesat nr.12/06 dt.12.06.2013,nr.13/06 dt.13.06.2013, nr.14/06 dt.14.06.2013, nr.16/06 dt.16.06.2013, nr.17/06 dt.17.06.2013,nr.19/06 dt 19.06.2013 nr.20/06 dt.20.06.2013 nr.21/06 dt.21.06.2013,nr.24/06 dt.24.06.2013, nr.26/06 dt.26.06.2013, nr.27/06 dt.27.06.2013, nr.28/06 dt.28.06.2013,01/07 dt.01.07.2013, nr.03/07 dt.03.07.2013, nr.04/07 dt.04.07.2013, nr.08/07 dt.08.07.2013, nr.11/07 dt.11.07.2013,nr.17/07 dt.17.07.2013, nr.18/07 dt.18.07.2013, nr.23/07 dt.23.07.2013, nr.27/07 dt.27.07.2013, nr.29/07 dt.29.07.2013, nr.30/07 dt.30.07.2013, nr.01/08 dt.01.08.2013, nr.02/09 dt.02.09.2013,nr.28/08 dt.28.08.2013, nr.20/08 dt.20.08.2013, nr.12/08 dt.12.08.2013,nr.11/08 dt.11.08.2013, nr.09/08 dt.09.08.2013nr.02/09 dt.02.08.2013, nr.03/08 dt.03.08.2013,nr.05/08 dt.05.08.2013, nr.06/08 dt.06.08.2013 përmesë të cilave ishte konstatuar borxhi dhe ishte nënshkuara në mesë paditësit dhe të paditurit,gjykata konform nenit 150 paragrafi 1 pika a,b,c të Ligjit për Procedurën Kontestimore(LPK) ,vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, duke përfshirë shpenzimet e kërkuara dhe argumentuar nga paditësi dhe atë; për taksën në padi shumë prej 368,64euro, , në shumë të përgjithshme prej 364,64uro.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 150 paragrafi 1 dhe nenit 143 paragrafi 1 të LPK-së,vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE

III.Ek.nr. 168/2016 të dt.29.05.2017

G j y q t a r j a

Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE:Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj Gjykate.